

**RAPORT (PARAPRAKE)  
VLERESIM TE NDIKIMIT NE MJEDIS  
PERMBLEDHJE JO TEKNIKE**

**LINJE PER PRODHIM TE PRODUKTEVE  
FARMACEUTIKE, PAKETIM DHE MAGAZINIM TE  
PRODUKTEVE FARMACEUTIKE DHE KOSMETIKE  
XHAFZOTAJ, KOMUNA XHAFZOTAJ, RRETHI DURRES,  
QARKU DURRES**

**SUBJEKTI: IMI FARMA.SH.P.K**

**QERSHOR 2014**

### **1.1. Hyjre**

Vendi yne eshte anetare e nje numri konventash nderkombetare, si rrjedhoje eshte i detyruar te zbatoje nje sistem sa me efektiv ne fushat ekonomiko-sociale dhe mjedisore, per rregullimin e territorit sidomos ne funksion te zgjidhjes se problemeve te ndryshme mjedisore.

Ky raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) duke u bazuar ne zhvillim strategjik te zonave urbane dhe suburbane te Komunes Xhafzotaj perfshin vleresimin, identifikimin, si dhe percaktimin e masave zbutese te ndikimit te projektit ne kete zone. Ky raport i VNM-se po pergatitet me kerkese te investitorit. Projekti eshte realizuar per aktivitetin "**Linje per prodhim te produkteve farmaceutike, paketim dhe magazinim te produkteve farmaceutike dhe kosmetike**", me vendodhje Xhafzotaj, Komuna Xhafzotaj, Rrethi Durres, Qarku Durres. Aktiviteti do te ushtrohet nga subjekti juridik "Imi Farma"Sh.p.k. Ne kete Vleresim do te paraqesim gjendjen, ndikimin e ketij projekti mbi mjedisin e zones dhe mbi njerezit (qofshin banore te zones perreth, punonjes apo vizitor). Gjithashtu do te shqyrtojme faktoret pozitiv dhe negativ mjedisor, do te paraqesim skemat e rehabilitimit, masat zbutese dhe reduktimin e impakteve negative.

### **1.2. Te dhena te pergjithshme.**

Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis ne kete raport eshte analizuar vetem kjo zone ne studim dhe nuk jane analizuar zona te tjera per shkak te aktivitetit egzistues. Gjithashtu eshte analizuar edhe aktiviteti qe ushtrohet ne kete zone ne studim.

Zonimi funksional i cili realizon edhe ndarjen e ketyre zonave percakton qarte sistemin e infrastruktures qe lidh zonen me rrjetet egzistuese. Objekti ne fjale eshte i pajisur me te gjitha elementet e nevojshem per linje te prodhimit te produkteve farmaceutike (barnave) bashkekohore dhe modern konform kushteve teknike si dhe jane projektuar vendparkimi per automjetet, rruge te brendshme si dhe ndarja nga rruga nacionale me breza te gjelber, nje mjedis perreth i sistemuar kendshem dhe i gjelberuar.

Zona e studiuar, konsiderohet si nje zone me zhvillim urban me densitet te ulet banimi dhe sherbimesh. Gjithashtu ne funksion te zones, lind nje kerkese me e larte persa i perket respektimit rigoroz te normativave te shfrytezimit te siperfaqes dhe distancave normative te percaktuara nga "Rregullorja e modelit te planifikimit te territorit" si dhe transparence, bashkeveprim dhe reference ne peizazhin e gjelber.

### **1.3. Pershkrim i kuadrit ligjor dhe institucional.**

#### **Metodologjia e hartimit te VNM**

Hartimi i ketij raporti VNM eshte bere ne perputhje me ligjin Nr. 10 440, datë 7.7. 2011,"Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis " ku sipas nenit 9 te ketij ligji ,percaktohen edhe projektet qe I nenshtrohen procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis ,sipas shtojces II (pika 6-b) veprimtaria e projekteve te fushes farmaceutike (jo proces kimik dhe biologjik) nenshtrohen Procedures Paraprake te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis

Gjithashtu hartimi i ketij raporti te thelluar te vleresimit te ndikimit ne mjedis eshte bere ne perputhje me ligjin Nr.10 431, datë 9.6.2011"Per Mbrojtjen e Mjedisit"i ndryshuar,i cili është përafëruar plotësisht me Direktivën 2004/35/KE të Parlamentit European dhe Këshillit, datë 21 prill 2004 "Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin"

Sipas Ligjit Nr: 10448 date 14/07/2011 " Per lejet e Mjedisit", projekti te se prodhimit te produkteve farmaceutike perket kategorise se Lejeve te tipit " B" konform Shtojces II.

Metodologjia e hartimit te VNM eshte hartuar ne perputhje me kerkesat e legjislacionit perkatës mjedisor te shprehura ne Udhëzimin Nr.3, datë 19.11.2009 "Per Metodologjine e Vleresimit te Raportit te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis. Vleresimi i ndikimeve ne mjedis nga aktiviteti I prdhimit te barnave ne zonen e projektit merr ne konsiderate se si keto procese gjate zbatimit te projektit ndikojne ne gjendjen ekzistuese te mjedisit te zones dhe me vone. Ndikimet kumulative qe mund te ndodhin mund te shfaqen menjehere kur ndodh nje nderhyrje ne mjedis apo shfaqen ne menyre indirekte dhe ato mund te shfaqin shkalle te ndryshme rendesie. Keto ndikime mund te jene te ndryshme ne kohe zgjatjen e ndikimit (Afatshkurter, Afatmesatar dhe Afatgjate ne kohe) dhe te ndryshme ne karakterin e tyre (ndikim i perkohshem dhe i perhershëm).

Vlersimi i ndikimeve ne mjedis te shkaktuara nga proceset e permendura me lart jane percaktuar per pritesit ne mjedis te ketyreve ndikimeve.

- Ekosistemetet natyrore, fauna dhe flora
- Toka dhe nentoka
- Hidrologjia ne mjedis (ujrat tokesore dhe ata nentokesore)
- Cilesia e ajrit
- Klima
- Peisazhi
- Shendetit publik dhe cilesia e jetes
- Pronesia (ndertimet e ndryshme dhe tokat bujqesore / kenetore)
- Trashegimnia kulturore, duke permbajtur ndertimet arkeologjike dhe ato tradicionale

Gjatë plotësimit të kërkesave hartuesit e këtij raporti grumbulluan informacionin e domosdoshëm, që përfshin:

- a) kërkesat e përdorimit të tokës dhe mënyrat e përdorimit aktual të saj nga zbatimi i projektit;
- b) ndërtimin e objekteve dhe instalimet e pajisjeve teknologjike që do të realizohen;
- c) proceset teknologjike, lëndët e para që do të përdoren, përfshirë edhe energjinë elektrike dhe produktin përfundimtar të procesit;
- d) shkarkimet në mjedis, si dhe mundësisht sasinë respektive të tyre;
- e) llojin e mbetjeve përfundimtare që do të prodhohen nga veprimtaria, si dhe sasinë e tyre;
- f) gjendjen aktuale të mjedisit ku do ushtrohet veprimtaria, si dhe karakteristikat e veçanta të tij, përfshi edhe statusin ligjor të zonës ku synon të ushtrohet veprimtaria;
- h) gjendja e infrastrukturës rrugore, elektrike, kanalizimet e ujërave, si dhe nevoja për infrastrukturë të re të projektit.

Vendimi (Nr.247, datë 30.04.2014):Per terheqjen e mendimit te publikut ne vendimarrje per mjedisin, pjesemarrja e publikut te ndikuar

1. Pjesëmarrja e publikut në hartimin e politikave, strategjive, rajonale e kombëtare, të përgjithshme dhe të planeve të veprimit, në zbatim të tyre, që kanë lidhje me mjedisin, përbën kërkesë ligjore në procesin e hartimit të këtyre dokumentave, që përmirëson përmbajtjen dhe lehtëson zbatimin e tyre .

2. Autoritetet publik gjatë procesit të hartimit të dokumentave të përmendura në pikën 1, të këtij kreu, pjesëmarrjen e publikut të ndikuar e realizojnë:

- a. duke i siguruar atij informacionin e nevojshëm për këto dokumenta;
- b. me përcaktimin e rregullave dhe procedurave sa më të thjeshta;
- c. me sigurimin e kushteve dhe të zgjidhjeve praktike, të përshtatshme për tërheqjen e mendimit të tij.

3. Për të garantuar pjesëmarrjen e publikut dhe kontributin e tij, autoritetet publike zbatojnë procedurat, si më poshtë vijon:

- a. Në përputhje me natyrën dhe përmbajtjen e dokumentit të hartuar, identifikojnë atë , që përbën publikun e ndikuar për rastin konkret;

b. Organizojnë njoftimin e publikut të ndikuar, se është hartuar projekti i dokumentit që do të bëhet objekt i debatit publik dhe e ftojnë publikun të njohet me të e të përgaditet për debat.

4. Njoftimi i publikut të ndikuar shpallet :

- a. në radio e tv, kombëtare e vendore;
- b. në faqen e internetit të autoritetit;
- c. në botime, të përditshme apo periodike, nëse është e mundur;
- d. në tabelën e njoftimeve, në vend të dukshëm.

5. Grupi hartues i dokumentit e ripunon atë, duke marrë parasysh çdo koment, informacion, analizë apo mendim të paraqitur nga publiku, që vlerësohet i vlefshëm, dhe harton relacionin, që shoqëron projekt-dokumentin, ku pasqyrohen vërejtjet e publikut, që nuk janë reflektuar në të, duke shpjeguar edhe arsyt pse nuk janë marrë parasysh.

6. Relacioni i përcillet organit vendimarrës, së bashku me projektin përfundimtar të dokumentit e me procesverbalin e debatit me publikun.

Hartimi i këtij raporti VNM është bërë në përputhje me ligjin Nr. 10 440, datë 7.7. 2011, "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis " ku sipas nenit 8 te këtij ligji, përcaktohen edhe projektet qe I nenshtrohen procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis , sipas shtojces I i nenshtrohen Procedures Paraprake te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis.

Gjithashtu hartimi i këtij raporti të thelluar të vleresimit të ndikimit në mjedis është bërë në përputhje me ligjin Nr.10 431, datë 9.6.2011 "Per Mbrojtjen e Mjedisit" , i cili është përafër plotësisht me Direktivën 2004/35/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 21 prill 2004 "Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin"

Sipas Ligjit Nr: 10448 date 14/07/2011 "Per lejet e Mjedisit", aktiviteti I prodhimit te produkteve farmaceutike i perket kategorise se Lejeve te tipit " B" konform Shtojces II.

Synimet e hartimit të VNM-se

Hartimi i këtij raporti VNM për projektin e zhvillimit të aktivitetit Prodhim të produkteve farmaceutike synon :

- Vlerësimin e përgjithshëm, të integruar dhe në kohë të ndikimeve mjedisore, të projektit që do zbatohet , duke parandaluar dhe zbutur ndikimet negative në mjedis;
- Një proces vlerësimi të hapur dhe të administruar me paanshmëri, nëpërmjet pjesëmarrjes së organeve qendrore e vendore, të publikut, të organizatave jofitimprurëse për mjedisin, të propozuesit të projektit dhe të personave fizike dhe juridike, të specializuar në këtë fushë.

Hartimi i këtij raporti VNM -je është bazuar gjithashtu në ligjin për mbrojtjen e mjedisit , i cili në vetvete synon :

- të rregullohet marrëdhënia ndërmjet njeriut dhe mjedisit,
- të mbrojtë përbërësit e mjedisit dhe proceset mjedisore
- të sigurojë kushtet materiale për zhvillimin e qëndrueshëm, duke plotësuar kuadrin e nevojshëm për zbatimin e kërkesës kushtetuese për një mjedis ekologjikisht të pastër.
- përdorimin racional të mjedisit dhe kufizimin e shkarkimeve e të ndotjeve në të, parandalimin e dëmtimit të tij, rehabilitimin dhe shëndoshjen e mjedisit të dëmtuar;
- përmirësimin e kushteve mjedisore, që lidhen me cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut;
- ruajtjen dhe mirëmbajtjen e burimeve natyrore, të përsëritshme dhe të papërsëritshme, administrimin racional dhe të frytshëm të tyre;
- bashkërendimin e veprimtarive shtetërore për të përmbushur kërkesat për mbrojtjen e mjedisit; • bashkëveprimin ndërkombëtar në fushën e mjedisit;
- nxitjen dhe pjesëmarrjen e publikut në veprimtaritë për mbrojtjen e mjedisit;
- bashkërendimin e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit me kërkesat e zhvillimit të qëndrueshëm;

- ngritjen dhe forcimin e rrjetit institucional te mbrojtjes se mjedisit ne nivel qendror dhe vendor.

**Parimet e Hartimit te VNM-se:**

Parimet bazë të mbrojtjes së mjedisit , ku mbështetet edhe ky raport VNM-je janë :

- a) parimi i zhvillimit te qëndrueshëm;
- b) parimi i kujdesit;
- c) parimi i parandalimit;
- ç) parimi "ndotësi paguan";
- d) parimi i riparimit te dëmeve mjedisore, përtëritjes e riaftësimit te mjedisit te dëmtuar;
- dh) parimi i përgjegjësisë ligjore;
- e) parimi i mbrojtjes ne shkalle te larte;
- e) parimi i integritit te mbrojtjes se mjedisit ne politikat sektoriale;
- f) parimi i ndërgjegjësimit dhe i pjesëmarrjes se publikut ne vendimmarrjen mjedisore;
- g) parimi i transparencës ne vendimmarrjen mjedisore.

"Zhvillimi i qëndrueshëm" i cili është zhvillimi qe plotëson nevojat e se tashmes dhe te se ardhmes pashtrenguar ose prekur mundësitë dhe kapacitetet qe edhe brezat e ardhshëm te plotësojnë nevojat e tyre.

"Përdorimi i qëndrueshëm " i burimeve natyrore e minerare I cili siguron plotësimin e nevojave te sotme, pa cenuar nevojat e brezave te ardhshëm për këto burime.

"Teknikat me te mira te mundshme" përfaqësojnë fazën me te përparuar dhe me nivel te larte te mbrojtjes se mjedisit, te zhvillimit te një veprimtarie dhe qe janë plotësisht te zbatueshme nga pikëpamja praktike dhe ekonomike.

"Parimi i parandalimit" është përzgjedhja dhe miratimi i variantit me te mire, qe ne fazën fillestare te vendimmarrjes, për te shmangur ndikime te dëmshme te një veprimtarie ne mjedis.

"Parimi i riaftësimit" është domosdoshmëria për te riparuar demet mjedisore te shkaktuara nga vete personat fizike e juridike dhe për te përtëritur dhe riaftësuar mjedisin e dëmtuar .

"Parimi "Ndotësi paguan"" nënkupton koston qe paguan ndotësi për përmirësimin e një mjedisi te ndotur dhe për kthimin e tij ne një gjendje te pranueshme.Kjo pasqyrohet në koston e prodhimit, te konsumit te mallrave dhe të shërbimeve qe shkaktojnë ndotjen.

Zona ne te cilen ndodhet aktiviteti ne studim ndodhet Xhafzotaj, Komuna Xhafzotaj, Rrethi Durres, Qarku Durres. Objekti eshte egzistues dhe eshte ndertuar para disa vitesh me miratimin e institucioneve perkatese. Pas sistemimit te objektit nga investitori qe paraqet kerkesen objekti eshte kompletuar edhe me teper me elementet e sherbimeve dhe te sigurise per personelin dhe klientet. Eshte perdor nje cilesi punimesh per fasadat e jashteme duke ndikuar ndjeshem ne rregullimin e peizazhit dhe eshte sistemuar ne kushte bashkekohore ambjenti si jashte edhe brenda duke perfshire siperfaqe te gjelber, vendparkim per automjetet, godine sherbimesh per punonjesit. Gjithashtu eshte rregulluar ne menyre te kendshme ambjenti i sherbimit perreth objektit te ri te ndertuar.

Zona perreth nuk ka ndonje densitet te konsiderueshem ndertimesh pervecse disa shtepi prane objektit dhe disa godina te tjera ne distance te mjaftueshme nga zona ne studim dhe te aktiviteteve Xhafzotaj, komuna Xhafzotaj te cilat edhe ato ndodhen ne nje distance te larget nga njera tjetra. Objekti ndodhet ne Durres ne Komunen Xhafzotaj larg zonave me perqendrim te larte urban. Terreni eshte relativisht i sheshte dhe zona perreth eshte e sheshte e cila dominohet nga toka te lena djerr te pa shfrytezuara perreth. Rruga kyesor lidhet me rruge hyrese dhe dalese te sistemuara dhe me hapesire per ngadalesimin dhe rritjen e shpejtesise. Infrastruktura eshte egzistuese dhe e lidhur me infrastrukturen e zones.

Theksojme se shume nga vleresimet e permbledhura te ndikimeve te mjedisit mbeshteten ne informacionet inxhinierike qe duhet te merren parasysh. Vleresimi identifikon ne menyre te qarte si perfitimet pozitive dhe negative dhe percakton perfundime te pergjithshme per secilen prej tyre. Vleresimi identifikon nese ndikimet jane mesatare te pranueshme, te rendesisheme, te drejtperdrejta apo te terthorte.

Vleresimi i shkurtër teknik i mëposhtëm bëhet me qëllim demonstrimin e vlerësimit të ndikimit mjedisor të aktivitetit të paraqitur kryesor Linje per prodhim te produkteve farmaceutike. Prona ku ndodhet ky aktivitet ushtrohet është në pronesi te pronarit i cili eshte perfaqesusei i subjektit Irakli Mio” i cili eshte dhe administrator i subjektit “IMi FARMA”Sh.p.k, i cili ndodhet fshatin Xhafzotaj, Komuna Xhafzotaj, Rrethi Durres, Qarku Durres paraqet kete raport te VNM (prane Qendres Kombetare te Licensimit per te kerkuar pajisjen **me Leje Mjedisore te Tipit B** sipas Ligjit Nr.10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”i ndryshuar, **nuk ka kapacitet te percaktuar per tu klasifikuar si pjese e kategorise se Lejes Tipi B por sipas procesit teknologjik pra procesit te kerkuar per te prodhuar produktet farmaceutike, pasi ti nenshtorht procedures se konsultimit me publikun.**

**2.**

**2.1. Situata aktuale e zones**

Zona ne te cilen ndodhet aktiviteti ne studim ndodhet Xhafzotaj, Komuna Xhafzotaj, Rrethi Durres Qarku Durres. Objekti eshte egzistues dhe eshte ndertuar para 1 viti.

Zona perreth eshte ne zhvillim te ndertimesh si pasoje dhe e shume projekteve te ndermarra nga Komuna, prane subjektit gjenden aktivite te ndryshme te tipit: prodhim duralumin, autoservise, disa magazina dhe aktivite te ndryshme tregtare si edhe shtepi ne distance te konsiderueshme nga objekti ne studim dhe te aktiviteve ne rrugen Xhafzotaj, Durres te cilat edhe ato ndodhen ne nje distance te larget nga njera tjetra. Objekti ndodhet prane rruges kryesore larg zonave te banuara, ne Komunen Xhafzotaj. Terreni eshte relativisht i sheshte dhe zona perreth eshte e sheshte e cila dominohet nga toka kenetore te pa shfrytezuara. Objekti lidhet me rrugen nacionale me rruge hyrese dhe dalese te sistemuara dhe me hapesire per ngadalesimin dhe rritjen e shpejtesise. Infrastruktura eshte egzistuese dhe e lidhur me infrastrukturen e zones.

**2.2. Qellimi dhe tiparet fizike te projektit.**

Ky vleresim i ndikimit ne mjedis do te paraqese nje informacion te permbledhur te projektit qe do te realizohet, ndikimet pozitive dhe negative ne mjedis dhe masat qe do te merren per zbatimin e kriterave te nevojshme per mbrojtjen dhe menaxhimin sa me racional te mjedisit.

Theksojme se shume nga vleresimet e permbledhura te ndikimeve te mjedisit mbeshteten ne informacionet inxhinierike qe duhet te merren parasysh. Vleresimi identifikon ne menyre te qarte si perfitimet pozitive dhe negative dhe percakton perfundime te pergjithshme per secilen prej tyre. Vleresimi identifikon nese ndikimet jane mesatare te pranueshme, te rendesisheme, te drejtperdrejta apo te terthorte.

**2.3. Te dhenat te pergjithshme per projektin.**

Subjekti "Imi Farma " paraqet kerkesen e saj per tu pajisur me Leje Mjedisore Tipi B per aktivitetin:

***Linje per prodhim te produkteve farmaceutike, paketim dhe magazinim te produkteve farmaceutike dhe kosmetike***

Respektimi i Planit te Menaxhimit Mjedisor nga ana jone do te mundesoj në minimizimin ose parandalimin e ndikimit te ketij aktiviteti ne menyre direkte apo indirekte ne mjedisin natyror dhe social te zones perreth. Duke vijuar me tej, risistemi i struktures ekzistuese te kesaj Ky aktivitet do të ketë ndikime direkte ose indirekte minimale apo te paperfillshme në aspektet social – kulturore dhe social – ekonomike të status te kesaj zone te klasifikuar si per veprimtari komerciale dhe zhvillim te industrise se lehte.

Ne tabelen e meposhime jane dhene treguesit kryesore tekniko te objektit.

<b>Nr</b>	<b>Emertimi i treguesve</b>	<b>Njesia e</b>	<b>Sasia</b>
<b>rendor</b>		<b>matjes</b>	
<b>A. Permasat e projektit</b>			

1.	Siperfaqja e prones	m <sup>2</sup>	7990
2.	Siperfaqe ndertimi	m <sup>2</sup>	3000.0

*Shenim: ne fazen perfunditmare te VNM do te percaktohen te dhenat e sakta dhe projekti i detajuar i zhvillimit te aktivitetit.*

## **2.4. INSTALIMET**

Ky raport i VNM po realizohet per aktivitetin "Linje per prodhim te produkteve farmaceutike, paketim dhe magazinim te produkteve farmaceutike dhe kosmetike" me vendodhje Fshati Xhafzotaj , Komuna Xhafzotaj, Rrethi Durres, Qarku Durres.

**1. Procesi kryesor qe realizohet eshte prodhimi i paracetamoli vetem proces mekanik, ku pasi vjen lenda e pare....testohet ne laborator ( te cilen e ka cuar ne mail) , mbas testimit, nqs si kalon provat asgjesohet nqs i kalon provat qe perbush cilesine kalon ne prodhim.**

Prodhimi ka vetem nje makineri ate bustinizuese., ku produkti vjen vjen pluhur (lenda e pare) hyn tek makineria, . makineria thjesht e ben ne formen e bustines. cdo gje eshte gati nuk kane asnje perzierje asnje gje...tek makineria e kupton besoj qe eshte nje proces ku futet pluri dhe pastaj kur del posht kapet tek bustina.

Pastaj kete produkt tani ne bustin (vetem paracetamoli) e cojne ne laborator prap per testim. mbasi testot cohet ne karantine per shitje.

Transportin per barnat e rregullojne qe e ben vete klienti. dhe lenda e para i vjen nga zhdoganimi dhe vetem per paracetamol.

**2. Barnat e tjera veterinare dhe per njeriun i marrin te gatshme dhe i ruajne ne karantine vetem i testojne e i cojne per shitje.**

**3. Asgjesimin e bejne nga kompani private qe bejne asgjesimin se bejn vete. asgjesimi behet kur kemi rastin qe lenda e para nga testimi sben ose kur barnat per shitje nga procesi nuk permbushin ate qe quhet Quality product/control (cilesi, sasi, pasterti, identiteti).**

**4. Laboratori ka personin pergjegjes ing kimist dhe drejtorin e prodhimit qe bashkepunon per proceset e tilla.**

**5. Transporti behet nga vete klientet. dmth skane mjete transporti**

**6. Karantina eshte nje vend te cilen e kane te ndare dhe ruajne dhe lenden e pare dhe produktin e gatshme pas testimeve, para testimeve e tje**

Pra linje prodhimi vetem per paracetamol (dhe makineria eshte vetem per paracetamol) te tjerat i marrin nga jashte , me zhdoganim me certifikatat e cilesise etj etj sic dhe i kerkon zhdoganimi vetem i testojne shitjet i kane vetem per depot (jo per kliente)



### **3. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE ME TE RENDESISHME NE MJEDIS.**

Nje nga objektivat e ketij raporti eshte identifikimi i ndikimeve te mundshme qe mund te shkaktohen ne mjedis nga ky aktivitet ne teresi. Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedisin e kesaj zone do te vleresohen ne njerën prej fazave pasi tashme ky objekt eshte egzistues, pra ne fazën gjate shfrytezimit te ketij objekti. Nuk marrin ne konsiderate fazën pas perfundimit te veprimtarise pasi ky objekt do te vazhdoje te jete i tille edhe pas shume e shume kohesh. Disa prej ndikimeve kryesore qe jane vleresuar si te mundshme jane paraqitur si me poshte.

Efektet e mundshme nga projekti qe do te implementohet do te vleresohen ne menyre te pergjitheshme nga ky raport VNM-je. Megjithate, shume nga efektet e mundshme mund te identifikoohen per arsye te eksperiences nga nen-projektet e projektet e meparshme ne kete fushe.

#### **3.1. Ndikimet me te rendesishme gjate funksionimit.**

##### **3.1.1. Shkarkime ne uje.**

Nuk kemi ndotje te ujerave nentokesore. Ujerat qe dalin nga aktiviteti i ketij aktiviteti jane ujera urbane te cilat lindin si rrjedhoje e aktivitetit human te pnonjesve. Gjithashtu nuk ka ndonje sasi te konsiderueshme te ujerave urbane pasi njolla e objektit eshte shume e vogel dhe stafi qe punon aty eshte ne numer te ulet.

Do te kemi konsumim te ujit dhe gjate vaditjes se mjedisit te gjelberuar por konsumimi i tij do te perdoret me eficence nga personat pergjegjes per mirembajtjen e mjedisit te gjelberuar perreth.

##### **3.1.2. Emetimet ne ajer.**

Emetimet ne ajer mund te vijne nga djegia e lendes djegese, qe do te vije vetem nga automjetet qe do te mbushen me karburant apo nga frekuentuesit e objektit, si dhe ne raste te rralla kur ka mungese te energjise elektrike dhe do te linde nevoja per ndezjen e gjeneratorit. Pra mund te themi se niveli i shkarkimeve do te jete i ulet, pra ne nivele te pa perfillshme, kjo vjen si rezultat se mjetet rrugore qe qarkullojne jane konform normave te percaktuar ne Udhezimin Nr 6527, date 24.12.2004 -Mbi vlerat e lejueshme te elementeve ndotes te ajrit ne mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkarkuar nga mjetet rrugore dhe menytrat e kontrollimit te tyre

Lëndët që do të depozitohen në rezervuar do të jenë dhe shkaku i ndotjes së atmosferës pasi veprimtaria e objektit nuk ndikon ne uljen e cilesise se ajerit. Ndotësit në gjendje të gaztë që do të prodhohen gjatë transportimit të produkteve mund të bëhen shkak të efektit të korrozionit.

##### **3.1.3. Zhurmat dhe vibrimet.**

Zhurmat qe do te prodhohen do te vijne kryesisht nga mjetet rrugore si dhe nga perdorimi i pompave te ujit, gjeneratoreve, zhurma e prodhuar nga vete personat qe do te punojne per kete veprimtari, etj. Montimi i pareteve me materiale termoizoluese do te sjell ndikim pozitive ne uljen e ndotjes akustike ne mjediset e brendshme te objektit. Kjo do te sjelle uljen e nivelit te zhurmave ne mjedisin perreth. Mjetet e qarkullimit rrugor do te jene konform kushteve teknike ne perputhje me ligjin ne fuqi, (cdo vit mjeteve rrugore ne Shqiperi u behet kontrolli teknik dhe pajisen me pulle te posatshme).

Punëtorët që do të ndodhen në mjedise ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin mund të shfaqen efekte ekstra-auditive si: rritje të stresit, bezdisjes, dhimbje koke deri në ulje të aftësisë së

dëgjimit, etj. Kjo do të sillte ulje të produktivitetit dhe rritje të mundësive të aksidenteve.

Nuk do të shkaktohen vibrime shqetesuese gjate funksionimit të aktivitetit.

#### 3.1.4. Ndikimi ne toke.

Keto procese nuk do të ndikojne negativisht ne toke dhe as ne dhe, kjo vjen si rezultat se gjate funksionimit nuk jane ushtruar veprimtari qe kane lidhje me ndryshime te tokes apo dheut.

Terreni i ketij objekti pervec siperfaqeve te gjelberuara eshte i gjithi i sistemuar dhe i shtruar me beton dhe pllaka dekoruese, gje e cila e eleminon mundesine per te pasur kontakt me token.

#### 3.1.5. Ndikimi ne flore/faune.

Kjo zonë nuk bënë pjesë në zonat e mbrojtura. Kjo zonë ka qenë tokë bujqësore ku më përpara mbillej me grurë ose misër për përdorim vetjak si dhe ka qenë e ç'veshur nga bimësia që e karakterizonin zonën përreth. Zona ku eshte ndertuar projekti ndikohet gjate funksionimit të tij. Do të kemi ndikim negative ne faune per vete karakteristikat e ketij projekti, por ndikime te pa ndikuara ne demtimin e saj.

#### 3.1.6. Mbetjet e prodhuara.

Mbetje te ngurta qe do te prodhohen nga konsumi i perditshem ne kete zone do te jene mbetjet e ngurta si plastike, shishe qelqi, materiale letre, mbetje organike, etj, te prodhuara nga punonjesit, kapaciteti do te jete ne nivele te ulta.

#### 3.1.7. Ndikime te tjera.

##### ***Ndikime te tjera ky studim do te kete:***

Nxehtesia e prodhuar nga impianti i ndricimit, impiantet energjitike sic mund te jene gjeneratore, sistemi i kondicionimit etj, si dhe gjate pranise se aktivitetet njerezor ne mjediset e objektit mund te shkaktojne ndotje termike si dhe mbingarkese te rrjetit te energjise elektrike, por keto ndikime do te merren parasysh gjate llogaritjeve te projektimit te kondicionimit te godines ne teresi nga vete projektuesit. Ndikim do te kete dhe nga ndricimi mjedisit perreth projektimi i impiantit te ndricimit eshte projektuar konform te gjitha kushteve teknike per te mundesuar nje ndricim sa me optimal dhe me eficence energjitike. Projektimi i objektit eshte bere eficient kjo si rezultat se siperfaqet e pareteve me shume dritare jane projektuar nga juglindja dhe lindja si dhe perdorimi i materialeve termoizoluese ul konsumin energjetik deri ne 50%. Ky projektim eficient do te sjell ulje te konsumit te energjise elektrike ne teresi.

Nga kjo godine nuk do te kete ndikim ne mjedis nga rrezatimi, sepse ne asnje ambient nuk do te perdoren materiale qe rrezatojne ne mjedis dhe qe kane impakt negative dhe per vete mjedisin human ne kete objekt.

Gjate magazinimit të mbejeteve mos përdorimi i të gjitha masave teknike të disponueshme për të zvogëluar shpëtimin e ndotesave në ajër mund të sjelle ndikim negative ne mjedisin e zones.

Ndotja e mjedisit vjen e nga mos marrja e masave të përshtatshme për largimin e avujve të prodhuar nga depozitat të cilat mund të bëhen shkak të shpërthimeve, rënies së zjarrit, helmimeve. Në rast se niveli i tyre e tejkalon normën ( $20 \text{ mg/N m}^3$ ) ato mund të sjellin asfiksion të punonjësve në këto mjedise. Për të shmangur avaritë do të vendosen instalimet përkatëse për trajtimin e ajrit siç janë marmitat ku do të vendosen dhe filtrat, tubi i shkarkimit, valvulat e ajrimit, të sigurimit dhe sigurimi i presionit në rezervuarët përkatës. Do të bëhet kujdes gjatë mbushjes së rezervuarëve që të shmangët çlirimi i sa më shumë gazrave në troposferës duke i përputhur mirë tubat e ngarkimit dhe të shkarkimit. Kontrollimi vazhdimisht i tubove nëse kanë rrjedhje dhe izolimi i tij ose ndërrimi i tyre.

Ne lidhje me konsumimin e lendeve djegese nga gjeneratori, te energjise elektrike dhe te ujit per konsum. Mungesa e energjise elektrike pervec shume problemeve te ndryshme qe has Korporata Elektroenergjitike, nje nga shkaqet eshte shtimi i kerkesave gjithmone e ne ritje te popullsise (banoreve, njesive tregtare dhe te sherbimit). Kjo vjen si rezultat i mungeses se shirave ne vend, mungesa e burimeve te tjera alternative si energjite e rinovushme, konsumimi i tij pa eficence energjitike dhe ne perfundim mungesa e sensibilizimit te popullsise. Por veprimtaria e ketij projekti do te ndikojte ne nivele te ulta ne keto burime pasi do ndjeke politika te posatshme ne lidhje me perdorimin racional dhe me eficence te tyre.

Ne permbledhje impakti social – ekonomik do te jete pozitiv, mbi te gjitha sepse projekti do te sjelle nje permiresim te gjendjes ekonomike te punonjesve qe do te punesohen ne kete veprimtari edhe pse ndikimi eshte ne nivele te ulta.

**3.2. Matricat permbledhese kryesore te ndikimeve ne mjedis.**

Keto matrica jane ngritur mbi bazen e seleksionimit te ndikimeve me te rendesishme duke pasur parasysh te gjitha fazat e projektit dhe jane grupuar ne dy matrica baze (te permbledhura) qe japin respektivisht ndikimet negative dhe pozitive.

**3.2.1. Permbledhje e ndikimeve negative ne mjedis.**

Tabele 4-1. Matrica permbledhese e ndikimeve negative me te rendesishme.

	Gjate funksionimit	Pas funksionimit
Ujerat siperfaqesore	- +	-
Ujerat nentokesore	- +	-
Toke/dhe	-	-
Biodiversiteti	-	-
Ekonomia	-	-
Infrastruktura	-	-
Shendet/higjiene	-	-
Ajri	- +	-

- - II.....Nuk ka ndikime negative.
- - + II.....Mund te kete ndikime negative shume te vogla.
- + II.....Ka ndikim .

**3.2.2. Permbledhje e ndikimeve pozitive ne mjedis.**

Tabele 4-2. Matrica permbledhese e ndikimeve pozitive me te rendesishme.

	Gjate funksionimit	Pas funksionimit
Ujerat siperfaqesore	-	-
Ujerat nentokesore	-	-
Toke/dhe	-	-
Biodiversitet	-	-
Ekonomike	- +	-
Infrastruktura	- +	-
Shendet/higjiene	-	-
Ajer	-	-

- - II..... Nuk ka ndikime pozitive.
- - + II..... Ka ndikim te vogel pozitive.
- + II..... Ka ndikime pozitive.

#### **4. MASAT KRYESORE LEHTESUESE.**

##### **4.1. Masat lehtesuese qe do te ndermerren gjate shfrytezimit te objektit.**

Vlerësimi i ndikimit në mjedis duhet të ndikojë në dhënien e zgjidhjeve për shmangie të aksidenteve dhe mbrojtjes së mjedisit. Mbrojta e mjedisit përbën në vetvete një sërë masash zbutëse, parandaluese.

Ne menyre te pergjithshme do te japim disa prej masave qe do te zbatohen nga kontratuesit pas zbatimit te projektit. Ndikimet negative ne mjedis gjate shfrytezimit te zones jane ne nivele shume te ulta. Disa prej masave kryesore qe do te ndermerren jane permendur ne menyre te permbledhur si me poshte shenuar.

Gjatë projektimit skema teknike e linjes ka siguruar:

- Shkarkimi brenda normave të avujve në ajër, rrjedhjeve ujore.
- Shmangie deri në minimizim të rrjedhjeve në ajër, ujë dhe tokë të shkarkimeve ndotëse për mjedisin.
- Tokëzimi i rrjetit dhe impianteve energjike.
- Instalime të MKZ-it.
- Menaxhimi me efikasitet i territorit.
- Në çdo periudhë do të realizohen matje dhe analiza.

Mbajtjen në gjendje shumë të mirë teknike (të pajisjeve, sistemit të ngarkim- shkarkimit, sistemit të kontrollit, i rezervuarëve, etj).

Ky objekt nuk do të prodhojë ndotës për mjedisin nëse merren masa për të rehabilituar dhe monitoruar vazhdimisht mjedisin e punës dhe depot e magazinimit. Mbetjet e ngurta urbane që do të prodhohen nga shërbimi në objektin ekzistues do të depozitohen në vendet e përcaktuar nga Komuna Xhafzotaj.

Nuk do të ketë ndotje akustike, rrezatimuse apo vibrime, etj që mund të jenë të rrezikshme për jetën e individëve dhe për mjedisin natyror. Për nevojat higjieno- sanitare, uji do të merret nga rrjeti i zones.

□ Në rast urgjencash kontaktimi me zjarrfikësit e zonës përkatëse (vendosja e numrit të Zjarrfikëses 128 në një vend të lexueshëm nga të gjithë punëtorët).

Percaktimi i vijes hyrese dhe dalese per automjetet rrugore qe do te furnizohen me revervuarëve si shmangia e aksidenteve gjate daljes nga ky shesh. Pajisja e kesaj rrugice me sinjalistiken perkatese.

Do te behet nje menaxhim sa me eficient i energjise elektrike. Impiantet e nevojshme per nje konfort termike ne objekt jane projektuar ne perputhje me Ligjin e ri, nr.9379, date 28-04-2005 'Per Eficencen Energjise", kjo do te coje ne uljen e ndotjeve termike te mikroklimes se zones si dhe kursim te energjise elektrike deri ne 50% nga perdorimi i materiale termoizolues.

Percaktimi i vend-parkimit te automjeteve si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistiken perkatese per objektin qe eshte ne shërbim te ketij aktiviteti.

Do te instalohet sistem i ujitjes per mjedisin perreth (varet dhe nga hapësira e planifikuar per gjelberim si dhe pozicioni qe ato do te kene) si dhe lagja me uje e rrugicave te brendshme gjate periudhes Maj-Tetor.

Do te behet menaxhimi i mbetjeve te ngurta, te cilat do te jene; lende te amballazheve, letra-kartona, qelqe, alumin si dhe lende organike te prodhuara nga punonjesit apo nga sherbimi qe do te realizohet ne kete objekt, ku keto mbetje do te depozitohen ne vendin e caktuar nga Komuna, ku firma do te marre masa per menaxhimin e ketyre mbetjeve te ngurta, do te vendosen ne kosha selektive (nese do te filloje zbatimi i projektit te menaxhimit te mbetjeve) ku me pas do te transportohen nga automjetet e pastrimit te qytetit per ne vendet e caktuara prej tyre. Mbetjet e ngurta urbane te prodhuara, do te depozitohen ne kosha te percaktuar nga Komuna, ku do te jete nje sasi prej 0.8kg/dite per banor ndersa per njesite eshte e variushme, eshte e lidhur ngushte dhe nga aktivitetet qe do te ushtrojne veprimtari ne godina. Per cdo objekt do te ndertohet xhepi i kontenjerit sipas kushteve te caktura nga sektori i pastrimit te Komuna Xhafzotaj.

Do te ndertohet kanali i drenazhimit te ujit te shiut nga catia ose e mjedisit perreth drejt mjediseve te gjeberuara, nje mundesi e mire dhe per vaditje dhe shmangie te derdhjes se tyre ne mjedis si dhe shmangie te perdorimit te ujit te pijshem per vaditje.

Mjedis i gjelberuar perreth do te jete nen kujdesjen e personelit qe do te punesohet vetem per punimet agro-mjedisore te nevojshme.

Do te tokezohet rrjeti elektrike per te shmangur ndonje shkarkese elektrike, konform kushteve teknike.

Do te merren keto masa kryesore te mbrojtjes kundra zjarrit per Objektin. Do te perdoret uji i marre nga rrjeti i shperndarjes se ujit apo nga rezervuaret qe do te vendosen ne sheshin perreth per rastet e emergjences (zjarret e mundshme qe mund te bien ne keto objekte). Numri maksimal i lejuar i kateve te objektit, shkalla e qendrueshmerise ndaj zjarrit e kerkuar per ndertesen dhe siperfaqja maksimale e lejuar e dyshemese ndermjet mureve mbrojtese kunder zjarrit, percaktohet sipas kategorise se rrezikut per zjarr te punimeve qe do te kryhen ne ndertese. Shkalla e qendrueshmerise ndaj zjarrit si dhe numri maksimal i lejuar i kateve ne teresi (ose te pjeseve te saj qe gjenden midis mureve mbrojtese kunder zjarrit) percaktohen sipas punimit me te rrezikshem per zjarr qe kryhet ne ndertese (ose te pjeseve te saj qe gjenden midis mureve mbrojtese kunder zjarrit). Rrjeti per shuarjen e zjarreve duhet te jete i lidhur me rrjetin e ujit perkates. Ndertimi i ujesjellesit te pavarur per fikjen e zjarrit lejohet vetem ne rastet kur nuk eshte e leverdiseshme qe aty te lidhet me ujesjellesin e ujit. Ne kete projekte harxhimi i ujit per shuarjen nga jashte te zjarreve duhet te merret 20 l/sek. Ujesjellesi per shuarjen nga zjarri duhet te ndertohet me presion te larte dhe te ulet. Hidratantet e brendeshme vendosen ne cdo kollone te nderteses, pervec mbi tavane, sepse ne tavane do te instalohet sistemi i sprinkler. Ne mjedise te tjera, hidrantet e brendeshme duhet te vendosen kryesisht prane hyrjeve brenda kthinave, ose ne pushimet e kafazeve te shkalleve, ne korridoret ose ne kalimet, pikerisht ne vendet me te dukshme. Hidratet zjarrefikese te brendeshme vendosen 1.25 m nga niveli i dyshemese ku kapaciteti i tyre mbajtes do te jete 70L per cdo hidrant te montuar ne keto mjedise. Per te mbrojtur kunder zjarrit te mundshem qe mund te bjer ne objekt do te ruhen largesite mbrojtese ndaj zjarrit ndermjet sheshit dhe objektit perreth si dhe ndermjete objektit qe ndodhet ne sheshin ne studim. Do te lihen distancat e percaktuara per rruge kalim te automjeteve, zjarrefiksive.

Per te shmangur ndotjen e ujerave nentokesore nga Ujerat te Ndotura Urbane te kesaj zone do te lidhet me rrjetin e kanalizimeve te kesaj zone, rrjeti do te projektohet konform kushteve teknike si dhe ne zbatim te legjislacionit ne fuqi. Ndersa ne lidhje ne burimet e furnizimit me uje, do te jene te mjaftueshme per te permbushur kerkesat gjate nje viti, veçanerisht gjate muajve te veres, kur normalisht kerkesa eshte me e larte.

Furnizimi me uje do t'ju sigurohet ne nje nivel te tille presioni, ne menyre qe te jete i

mjaftueshem per te shpermdare sasine e nevojshme te ujit edhe per katet e tjera te objektit, por jo aq sa te demtoje pajisjet hidraulike (efekti i grushtit hidraulik) ose te krijojte rreziqe tek konsumatori. Gjithashtu rrjeti hidraulik te furnizimit me uje per objektin do te sigurohet uje i pijshem i sigurt, bazuar ne Standardet Shqiptare, ne çdo kohe perdoruesve brenda sherbimit te zones se caktuar. Uji do te jete bakteriologjikisht dhe kimikisht i sigurt per perdorim sipas nevojave te caktuara ne perputhje me standardet shqiptare.

#### **4.2. Shperndarje e informacionit per publikun.**

Institucionet perkatese kane mundesuar informacion per projektin per gjithe Autoritetet Vendore, per Komunitetin si dhe per Kryetarin e Komunes ku do te implemtohet projekti i propozuar. Pervec kesaj, personat pergjegjes kane njoftuar komunitetin kjo edhe e trajtuar gjeresisht ne mbledhjet e Keshillit te Komunes rreth objektivave te projektit, impaktet e ngjashme e perfitimet nga realizimi i ketij projekti si dhe perfitimet per komunitetin e kesaj zone. Survejimi social-ekonomik i objekteve te prekura tregon se pjesa me e madhe e pergjigjeve kane qene pozitive per projektin para se te beheshin te tilla survejime.

Konsultimet me publikun do te behen ne perputhje me proçedurat e percaktuara ne ligjin shqiptar per VNM, te perpunuar me sakte ne Rregulloren Nr.1 -Per pjesemarrjen publikell me titull -Per Pjesemarrjen Publike ne Proçesin e VNM-se te dates 17.8.2004 (Nr.233 Prot.) te pergatitur nga MM. Kjo rregullore eshte pergatitur ne zbatim te nenit 26 te ligjit per VNM.

#### **4.3. Rreziku per aksidente dhe projekte te demshme.**

Gjate funksionimit mund te sjelle rrezikshmeri per aksidente. Ne rast se do te kemi derdhje te lendeve si hidrokarbure nga automjetet e transportit do te merren masa per largimin e saj nga mjedisi si dhe do te vendosen tabela sinjalizuese per te shmangur aksidente rrugore gjate hyrjes dhe gjate daljes si nga sheshi i punimeve per sistemim dhe gjate shfrytezimit te zones.

## **5. PROGRAMET PER NDIKIMIN NE MJEDIS TE AKTIVITETIT.**

### **5.1. Skema e monitorimit te treguesve mjedisor.**

Monitorimi i burimeve natyrore, ajrit, ujit, tokes, derdhjeve urbane etj, kryhet sipas disa kriterëve shkencore persa i perket vrojttimeve, mbledhjes dhe analizave te mostrave. Ai synon ne mbledhjen e te dhenave per te vrojtuar dhe parashikuar rolin e faktorit njeri dhe natyror ne ndryshimet e mjedisit, ku ai eshte aktiv.

Për të shmangur avaritë dhe aksidentet gjatë funksionimit do të bëhet monitorimi i rezervuarëve sipas një grafiku të përcaktuar nga investitori dhe nga inspektorati përkatës. Monitori i vazhdueshëm i mjedisit të punës edhe ne objekt do të sjellë ulje të ndotjes së mjedisit.

Objektivat kryesore te monitorimit jane:

- Per te zbuluar ndryshimet dhe per te karakterizuar saktesisht nga ana sasiore tendencat (prirjet) e zhvillimit te burimeve.
- Per te siguruar informacione mbi lidhjen midis kushteve (gjendjeve) te burimeve dhe shkaqeve te tyre.
- Per te evidentuar cilesine e mjediseve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetesor, me synim per te marre masat e nevojshme per permiresimin e tyre.
- Per te vleresuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve per menaxhimin e burimeve natyrore.

### **Monitorimi eshte detyre e shoqerise investitore ne nivel individual per pikat C1, C2, C5, C6, C7, C8 te Vendimit "Per monitorimit e mjedisit ne RSH", kreu III, pika 10**

Investitori do te monitoroje keto treguese te trysnise ne mjedis te cilet jane:

Ç-1. Per ndryshimet klimaterike(a, b);- nuk do te monitorohen nga investitori sepse nuk ka ndikim kjo veprimtari ne keto tregues mjedisor ne permasa kaq te larta sa te ndikoj ne ndryshim te klimes se ketij rajoni pasi ne kete objekt nuk do te ushtrohet asnje proces industrial dhe nuk do te emetohen ndotesa industrial te gazte ne kete zone.

Ç-2. Per ajrin urbane(a, b, c, ç, d);- gjate fazes se sistemimit ne bashkepunim me inspektoriatin e mjedisit do te monitorohet cilesia e ajrit urban, ku do te monitorohen keto tregues gjate fazes se sistemimit /montimit te makinerive si:

- Oksidet e Azotit (NOx),
- Lenda e grimcuar ne suspension, kryesisht pluhuri total LGS dhe ai i respirueshem PM10,-- keto emisione mund te clirohen gjate fazes se germimit dhe rehabilitimit te zones perreth dhe do te monitorohen gjate punimeve per hapje te themeleve per objektin si dhe ne raste kur ka erera te forta do te nderpriten punimet e germimeve.
- Dyoksidi i squfurit (SO<sub>2</sub>),-- qe mund te clirohet ne permasa shume te ulta nga lendet djegese te ndonje mjeti rrugore.
- Ozoni (O<sub>3</sub>),
- Plumbi,-- nga djegia e benzines tek mjetet rrugore.

Ndersa ne lidhje me ushtrimin e sherbimit ne kete objekt nuk do te kemi ndikim ne cilesine e ajerit pasi do te merren masa per ndalimin e ndotjes se ajerit. Burim energjije do te perdoret energjija elektrike. Ne lidhje me gjeneratorin ndotja do te jete ne nivele te uleta pasi do te perdorin Diesel si lende djegese, i cili eshte i kontrolluar me perpara nga institucionet perkatese para se te perdoret. Gjeneratori do te jete i standartizuar konform kushteve te vendeve te KE-se.

Openimi i pajisjeve dhe i makinerive gjate gjithë procesit te funksionimit, kerkon te monitorohet niveli i zhurmave, i cili nuk duhet te kaloje nivelet e caktuara. Ndotja akustike ne mjediset e punes (ne objekt) eshte paresore per shoqerine, sepse sjell uljen e produktivitet te punonjesve

dhe rritje te stresit (efekte eksta-auditive).

Ç-5. Per shkarkimet e ngurta , industriale dhe inerte(a, b, c, ç, d);-- plani i monitorimit gjate operimit, lidhur me pastrimin dhe pergatitjen e sheshit, ka si synim qe te evitohet prerja e drureve gjate pergatitjes se shesheve te punes ku ne zonen ne studim nuk konstatohen peme te larta. Hedhja e materialeve te nxjerra nga pregatitja e sheshit te punes kerkon mbajtjen e shenimeve perkatese ne regjistrimin e punimeve te kryera per sistemim dhe i mbetjeve inerte. Per kete qellim duhet te behet dokumentimi i materialeve te ngurta te parrezikshme qe hidhen ne vendet e paracaktuara nese ka te tilla.

Gjithashtu dergimi i materialeve te operimit dhe i pajisjeve ne shesh ben te nevojshem inspektimin e perhershem, i cili duhet te realizohet ne lidhje me kontrollin e emetimeve te pluhurit ne atmosfere gjate transportit te dheut.

Minimizimi i erozionit, duhet te jete nje detyre primare gjate pergatitjes se sheshit te sistemimit. Monitorimi i te gjitha dokumentacionit te projektit te miratuar, etj eshte objekt i kontrollit te vazhdueshem te shoqerise zbatuese. Do te monitorohen ne menyre konstante niveli i ujerave nentokesor per te shmangur efektin e mbytjes se depozitave gjate sezoneve me reshje.

Gjate fazes se sistemimit kur te fillojne germimet ne terren do te inspektohen te gjitha punimet javore nga ekspertet perkates per tu siguruar qe masat per erozionin e tokes jane siguruar sic duhet.

Ne raste se konstatohet qe masat nuk jane zbatuar ashtu sic duhet atehere eksperti do te njoftoje menjehere kontraktuesin dhe supervizorin i cili do te jete i pergjegjshem qe te merren masat e duhura dhe korrekte.

Ç-6. Per shkarkimet e lengeta industriale( a, b, c);-- nuk do te kete monitorim te ndotesave te lenget industrial pasi nuk do te kete veprimtari te tilla ne kete projekt. Monitorim do te behet vetem per shkarkime te lengeta qe do te prodhohen gjate zbatimit te ketij projekti. Ne fillim monitorohet para operimit per te vendosur kushtet fillestare, duhet bere ne zonat qe ka vendosur supervizori. Monitorimi fillestar i cilesise se ujit rekomandohet ne zonat me burimet me te medha te ndotjes potenciale te ujit (kampet e operimit dhe te burimeve te tjera te rrjedhjeve te rendesishme dhe prodhimit te ndotesve te lenget jo industrial).

Rekomandohet matja e grimcave ne suspence (MES), kerkesa biologjike per oksigjen DBO<sub>5</sub>, konduktiviteti dhe coliformet fekale dhe niveli i vajrave e grasove apo te hidrokarbureve te lengeta.

Frekuenca e monitorimeve do te percaktohet nga inspektoret e mjedisit(supervizori) gjate punimeve. Monitorimi i ujerave te ndotura urbane gjate shfrytezimit nuk do te realizohet nga institucioni pasi eshte detyre e institucioneve perkatese shteterore si mund te jete ISHP(Instituti i Shendetit Publik), etj. Detyre e kontraktuesit jane lidhja e rrjetit te kanalizimeve me piken e shkarkimeve te percaktuar nga Drejtoria e Ujesjelles Kanalizimeve si dhe monitorim sezonal –jo periodik i dekantuesit rezerve qe do te perdoret per shmangie te derdhjeve aksidentale ne mjedisin perreth.

Ç-7. Per burimin e ndotjes qe shkaktojne ne ajer;-- burimet kryesore qe shkaktojne ndotjen e ajerit gjate operimit jane; nga automjetet rrugore qe do te perdoren, nga germimi, nga pajisjet e ndryshme, nga njerezit, etj. Ndersa gjate funksionimit do te prodhojne ndotje te ajerit ne nivele te uleta si: automjetet rrugore, gjeneratori, tubi i ajerimit te depozitave me lende djegese ne funksion te ketij objekti, etj.



Monitorimi para operimeve per te vendosur kushtet fillestare, duhet bere ne zonat qe ka vendosur supervizori, perbrenda zones qe do te ushtrohet ndikimi.

Monitorimi me aparate per ndotesit e ajerit(fotometer, etj), pervec grimcave totale ne suspence nuk konsiderohet e justifikueshme ne kushtet ekzistuese te ambjentit, sepse nuk ka impakte te rendesishme ne kete projekt.

Masat e sigurise per monitorim shtese me kerkese te supervizorit do te specifikohen nese hasen rrethana te paparashikuara.

Ç-8. Sasia vjetore e kimikateve te rrezikshme te importuara.—ky projekt nuk perfshin ne asnje stad importimin e kimikate te rrezikshme dhe toksike te asnje lloj apo te demshme per mjedisin natyror dhe njerezor.

Disa tregues te tjere qe do te monitorohen ne linjen e prodhimit te produkteve farmaceutike jane:

1. Gjendja shëndetësore e punonjësve (një herë në 3 muaj).
  - Numri i ditëve me raport.
  - Diagnoza e punonjësve në gjendje jo të mirë shëndetësore.
2. Gjendja teknike e instalimeve(cdo dite).
  - Pajisjet, tubacionet, rrjeti i shpërndarjes, shkarkim-ngarkimit.
  - Sistemi i matjeve dhe i kontrollit mekanik dhe automatik.
  - Kontrolli i rezervuarëve dhe sistemit te ventilimit.
  - Regjistri i punëve të kryera.
3. Kontrollimi i sipërfaqeve të mbjellave(nje here ne tre dite).
4. Matja e sasisë së burimeve natyrore të shpenzuara(nje here ne muaj).
5. Matja e sasisë së energjisë kW/h të shpenzuar(nje here ne muaj).

**Programi i monitorimit do te perdoret per te verifikuar qe te gjitha ndotjet e mundshme qe do t'i shkaktohen mjedisit nga shfryezimi i ketij projekti do te jene ne nivele te pranueshme dhe ne perputhje me nivelet e percaktuara ne legjislacionin/direktivat perkatese. Investitori do te monitoroje vetem pikat per te cilat ai ndikon mbi to (pikat do te percaktohen nga organet kompetente), si dhe i dergojne keto te dhena ne AKM, te pakten dy here ne vit. Keto te dhena do te vihen ne dispozicion te inspektoreve te mjedisit gjate inspektimit te tyre ku nga ana e firmave kontraktuese do te kete gjithmon bashkepunim.**

Realizimi i objektivave dhe treguesve te pritshem te parashikuar ne projekt do te varet nga respektimi i te gjithe treguesve te percaktuar.

Kontrolli, monitorimi dhe permiresimi i vazhdueshem, sipas kushteve te shfrytezimit te krijuar gjate aktivitetit, do te çoje perfundimisht ne perfitimin e pamjeve te parashikuar ne projekt me siperfaqe te sistemuar dhe te gjelberuar.

## **6. REKOMANDIME.**

- I. Te realizohet ndricimi perreth (vendosja e instalimeve te ndricimit) te pershtatshem dhe me eficence energjitime.
- II. Investitori te respektojte detyrimet e vena ne Lejen e Mjedisit qe do te miratohet nga DRM ne bashkepunim me MMPAU, lidhur me monitorimin periodik te treguesve te trysnise mjedisore, tubit te ajerimit, avullimet, etj. Shoqeria te operojte ne perputhje te plote me normat qe jane ne fuqi dhe te kryej monitorime te vazhdueshem te tregueseve mjedisor.
- III. Te kryhet rregullimi i territorit ne perputhje me kondicionet urban te percaktuara per secilin rast.
- IV. Te respektojte te gjitha masat e percaktuara ne kete raport.
- V. Nderhyrjet e nevojshme ne rrjetin e infrastruktures te kryhen me lejen e institucioneve perkatese.
- VI. Sistemimi i lulishteve me peme si dhe drure dekorative te cilet te jene te gjelberuar gjate periudhes se veres dhe jo gjate periudhes se dimrit kur jane shume prane dritareve, shtrimi dhe asfaltimi i rrugeve, etj, do te permiresoj ne menyre te dukshme situaten ekzistuese ne kete zone.
- VII. Mbajta paster e mjedisit te zones do te jete dhe do te behet ne vazhdimesi per te garantuar nje mjedis te kulturuar.
- VIII. Ne respektojte te gjitha rregullat e mbrojtjes kundra zjarrit gjate operimit ne ndertese dhe te respektojte rregulloren e MKZ per objektet publike.

### **Ne perfundim mund te themi se:**

Projekti ne vleresim me perfaqesues te subjektit "Imi Farma"Sh.p.k per aktivitetin "Linje per prodhim te produkteve farmaceutike, paketim dhe magazinim te produkteve farmaceutike dhe kosmetike" nga ky raport ne teresi ka ndikim te ulet negative ne mjedisin e zones se fshatit xhafzotaj, Komuna Xhafzotaj, Rrethi Durres, Qarku Durres.

Investitori do te jete gjithmone i hapur per te bashkepunuar me institucionet perkatese te mbrojtjes se mjedisit, te cilat do te monitorojne gjate fazes se shfrytezimit, me qellim eleminimin e cdo impakti negative ne mjedis, sado i vogel qofte ai. Investitori eshte ne dijeni te te gjitha bazes legjislative ne lidhje me mjedisin dhe eshte gjithmon i gatshme per cdo bashkepunim midis institucioneve pergjegjese per mjedisin. Gjithashtu do te ndjeke te gjitha masat qe do te percaktohen ne Leje Mjedisore Tipi B.

**Ky raport u pergatit nga:**

*Brisilda Saraci*



Brisilda SARACI

Vleresues i Ndikimit ne Mjedis dhe Auditues Mjedisor

Nr. 4995 Prot; Nr.Idetifikues.73, date 04.07.2013

**SHTOJCA 1:**

**Inspektimi ne terren,**

Foto te objektit dhe ndertesave dhe objekteve te sherbimit



Foto te objektit te jashtem

